## DITURIA E RUMIT - Mevlana

Xhelaluddin Muhamed Rumi, i njohur edhe si Mevlana, ishte poet, jurist, dijetar islam, mendimtar dhe humanist. Mençuria dhe mendimet e tij nuk e humbin peshën dhe rëndësinë e tyre as shekuj më vonë. Ai lindi në Belha (Afganistani i sotëm) në vitin 604, sipas llogaritjeve islame, pra më 29 shtator 1207 (shek. XIII). Këtu është një përzgjedhje e vogël e mendimeve të tij të zgjuara.

"Pashë shumë njerëz që nuk kishin kostume, por edhe shumë kostume ku nuk kishte njerëz".

"Ata që flasin të njëjtën gjuhë nuk mund të pajtohen. Vetëm ata që ndajnë të njëjtat ndjenja mund të pajtohen."

"Pasionet janë si zjarri, dhe dëshirat janë si një pemë. Zjarri shuhet kur nuk ka dru, dhe pasionet kur dëshirat e tyre nuk plotësohen".

"Nëse një qiri ndez një qiri tjetër, ai nuk do të humbasë asgjë nga drita e tij."

"Dy gjëra shkatërrojnë jetën e një personi: tradhtia nga një mik dhe mëshira nga një armik."

"Të zbulosh sekretet e një personi që i pëlqen të flasë shumë është si të hedhësh ujë në një qyp të thyer".

"Edukoni fillimisht zemrën tuaj, pastaj gjuhën tuaj. Sepse fjalët vijnë nga zemra dhe më pas nga goja".

"Kur mendja bashkohet me mendjen tjetër, drita rritet dhe rruga ndriçohet. Kur egoja bashkohet me një ego tjetër, errësira rritet dhe rruga errësohet".

"Emrat nuk kanë rëndësi. Trëndafili do të kishte erë edhe sikur të quhej ndryshe".

"Nuk është e çuditshme kur një dele ikën nga një ujk, por është e çuditshme kur ajo dele bie në dashuri me një ujk".

"Të kam dëgjuar të bësh thashetheme për mua. Vërtet më befasoi që nuk më flet në fytyrë por pas shpine...Ti ke frikë nga unë i pafuqishëm, ndërsa duhet të kesh frikë nga Allahu.

"Edhe një lot e ka detyrën e vet. Është detyra e tij të hapë rrugën për buzëqeshjen që vjen pas".

"Praktikoni dy gjëra pak, dhe njërën shumë: ha pak, - fol pak, - mendo shumë".

"Dashuria nuk ka ngjyrë gri. Kur bëhet fjalë për dashurinë, duhet të vendosni për të zezën apo të bardhën..."

"Një gjarpër mund të të marrë vetëm jetën, dhe një mik i keq mund të të çojë në ferr".

"Kujdes me që ecni e me që rrini, se bilbili të shpie në kopshtin e trëndafilave dhe sorra në plehra".

"Mos i shit pasqyra në pazar të verbërve dhe mos u këndo këngë në pazar të shurdhërve".

SEANCA E 39-të E BORDIT TË ORGANIZATËS SË REGJISTRUAR PËR FONDIN E SOLIDARITETIT DHE ANËTARËSISË

# VENDIM I PËRKOHSHËM PËR PAGESËN E NDIHMËS PAS VDEKJES

Bordi vendosi që shuma e ndihmës pas vdekjes, që u paguhet anëtarëve të familjeve të pensionistëve të vdekur, të jetë 25.000 denarë, duke filluar me ndalimin e pagesës së pensionit për muajin shkurt 2022, me atë që përfituesit e ndihmës pas vdekjes do të ketë të drejtë në diferencë prej 5000 denarë (nga 25.000-30.000 denarë)

Më 7 shkurt të këtij viti Bordi i Organizatës së Regjistruar për Fondin e Solidaritetit dhe anëtarësimit, pas miratimit të rendit të ditës dhe pas një diskutimi të gjerë, konstatoi se gjendja e këtij fondi nuk është e mirë, sepse numri i pensionistëve të vdekur është në rritje për shkak të pandemisë Covid19, për shkak se edhe me vendimin e fundit për mbajtjen e një pjese të pensionit nuk u arrit të stabilizohet situata. Për momentin mbi 4100 persona janë në pritje të pagesës dhe koha e pritjes është rreth 4 muaj. Lidhur me këtë situatë të fondit të solidaritetit, në diskutim u vu në dukje se pas deklaratës së mjekëve specialistë, së shpejti pritet të ulet numri i të sapoinfektuarve, e me këtë edhe numri i të vdekurve nga kjo pandemi, gjë që do të ndikojë në stabilizimin e fondit të solidaritetit.

Pas një diskutimi të gjerë, Bordi njëzëri mori vendim që shuma e mbajtjes për fondin solidar - ndihmë pas vdekjes caktohet në shumë prej 150 denarë duke filluar me pagesën e pensionit për muajin shkurt të vitit 2022 deri në pagesën e pensionit të qershorit të vitit 2022. Bordi vendosi që shuma e ndihmës pas vdekjes, që u paguhet anëtarëve të familjeve të pensionistëve të vdekur, të jetë 25.000 denarë, duke filluar me ndalimin e pagesës së pensionit për muajin shkurt 2022, me atë që përfituesit e ndihmës pas vdekjes do të ketë të drejtë në diferencë prej 5000 denarë (nga 25.000-30.000 denarë) pas grumbullimit të mjeteve të nevojshme për pagesën e ndihmës pas vdekjes, sipas evidencës që mban FSPIMV.

Bordi gjatë vendosjes ka marrë parasysh dispozitën e nenit 116 paragrafi 2 të Ligjit për sigurimin pensional dhe invalidor, i cili përcakton se Bordi është kompetent për të përcaktuar masën e mbajtjes për ndihmën pas vdekjes, shumën e pagesës së ndihmës pas vdekjes në varësi të mjeteve të grumbulluara dhe vdekshmërinë e përfituesve të pensionit.

Bordi i organizatës së regjistruar për fond solidariteti dhe anëtarësim ka diskutuar edhe për "draft" versionin e ndryshimeve dhe plotësimeve të Ligjit për sigurimin pensional dhe invalidor dhe ka konstatuar se edhe Lidhjet e shoqatave të pensionistëve me aftësi të kufizuara propozojnë që dispozitat e këtij ligji që i referohen Fondit të solidaritetit dhe anëtarësimit, që nuk duhen ndryshuar apo plotësuar, sepse kështu do të hyhet në organizimin e pensionistëve në vendin tonë, e cila funksionon pa probleme prej më shumë se 75 vitesh. (LSHPM)

SHP-VELES

# Takimi i 27-të i manifestimit "Ëmbëlsira e gjyshes"

Më 3 mars, në restorantin "Bella Voda" në Liqenin e Velesit u shënua 27 vjetori i Manifestimit republikan në Shoqatën e Pensionistëve-Veles "Ëmbëlsira e gjyshes". Manifestimi "Ëmbëlsira e gjyshes" u mbajt për herë të parë në vitin 1994, falë idesë së pensionisteve tona të cilat me entuziazmin dhe angazhimin e tyre vetëmohues kontribuan për t'i dhënë kuptim ekzistencës së Aktivit të Grave, për të ruajtur traditën tonë në mënyrë që rrënjët mos të humbin. Me këtë ngjarje dëshirohet që t'ua përcillet brezave të rinj diçka që e kemi trashëguar nga gjyshet tona që të mos harrohet dhe të mbetet përgjithmonë ashtu siç është e përjetshme Maqedonia jonë. Edhe sivjet është ndjerë shija e "Ëmbëlsirës së gjyshes", për të cilën kanë kontribuar shumë pensioniste punëtore nga aktivet e grave – pensioniste nga shoqatat e pensionistëve të vendit tonë. Ata e pasuruan tryezën me lloje të ndryshme të ëmbëlsirave të vjetra tradicionale të Maqedonisë. Të gjitha ëmblëlsirat ishin të shijshme dhe për këtë arsye u shpallën të gjitha më të bukurat dhe më të shijshmet.

Të ftuar në këtë manifestim ishin përfaqësues të Komunës së Velesit, Komunës së Çashkës dhe Bordit Komunal të Kryqit të Kuq të Velesit. Manifestimin fillimisht e përshëndeti kryetari i Shoqatës së pensionistëve nga qyteti nikoqir, Vele Aleksoski. Të hapur e shpalli kryetari i Kuvendit të LSHPM-së, Ilija Adamovski. Kryetarja e Aktivit të Gruas pranë Shoqatës së Pensionistëve-Veles, Blagojka Nastova, i përshëndeti kryetaret e shoqatave dhe i falënderoi për angazhimin vetëmohues në përgatitjen e ëmbëlsirave tepër të shijshme. Të ftuarit i ka argëtuar muzika e bukur e grupit "Kajshar Band", interpretues i njohur i këngëve të vjetra maqedonase. Manifestimi "Ëmbëlsira e gjyshes" përfundoi me një premtim se së shpejti do të takohemi edhe me raste të mira që të mos ndalet miqësia e pensionistëve nga të gjitha shoqatat, anëtare të LSHPM-së. Nada Aleksoska

## Pensionisti nga rrethi i Strugës pastron nga bora rrugët në shtatë fshatra

Lulëzim Mena, një pensionist 64 vjeçar nga fshati Mislodezhda e Strugës, ka katër vjet që me iniciativën e tij, me makinën e vet, të cilës i ka vendosur një pllug, pastron dëborën nga rrugët lokale që të çojnë në një duzinë fshatra në rajonin e Strugës, të cilat gravitojnë deri te Mislodezhda e tij. Lulëzimi vjen shpesh herë i pari, para se të vijnë ata që janë të detyruar të pastrojnë rrugët. Mena është një pensionist që e ka kaluar jetën e tij të punës në Zvicër, por para disa vitesh është kthyer në vendlindje. Një shembull i mirë që të tjerët ta ndjekin sa më shumë dhe si munden. Bravo Lulëzimit! Stojan Kukuneshoski